



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND



RAPORTI VJETOR 2017



FOND KOSQAR PER GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

GUARANTEE AGREEMENT No. KCGF-06-16
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND



TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I, INFORMATA TË PËRGJITHSHME	03
Fjala e drejtorit menaxhues	04
Akronimet	06
Përmbledhje e treguesve financiarë	07
 PJESA II, PROFILI I INSTITUCIONIT	 09
Themelimi i FK GK-së dhe statusi i saj	10
Misioni	10
Vlerat institucionale	11
 PJESA III, QEVERISJA KORPORATIVE	 13
Bordi i Drejtorëve dhe personeli	14
Struktura organizative	16
Komitetet	17
Komiteti i Menaxhimit të Riskut	17
Komiteti i Auditimit	17
Bashkëpunëtorët e FK GK-së	18
 PJESA IV, PERFORMANCA E FK GK-së	 21
Struktura e kapitalit dhe investimet	22
Zhvillimi i portofolit të garancive	24
Menaxhimi rrezikut kreditor	30
Kualiteti i portofolit	30
Risia e 2017-s - SIDA	32
 PJESA V, AKTIVITETET GJATË 2017-s	 35
Lidhja e marrëveshjeve të reja	36
Punëtoritë/Seminaret	38
Analizat për ngritje të efikasitetit dhe përmirësim të kualitetit të shërbimeve	39
Takimet e Bordit të Drejtorëve dhe e komiteteve përkatëse	40
 PJESA VI, PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA	 43

PJESA 1



INFORMATA TË PËRGJITHSHME

FJALA E DREJTORIT MENAXHUES

Të nderuar lexues, partnerë dhe donatorë të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore,

Viti 2017 ishte viti i parë, i plotë, në aspektin operativ për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK). Një vit që na mundësoi, të gjithë ne, të kuptojmë rëndësinë që skema garantuese e FKGK-së ka në procesin e lehtësimit të qasjes në financa për ndërmarrjet Mikro të Vogla dhe të Mesme (NMVM). Përdorimi gjithnjë në rritje i shërbimeve garantuese të FKGK-së nga bankat komerciale në vend është sinjal pozitiv për arsyeshmërinë ekonomike të ekzistencës së FKGK-së, si institucion i themeluar me qëllim të mbështetjes së investimeve dhe ndërmarrësish private në vendin tonë.

Për më tepër, viti 2017 do të mbahet mend për disa ngjarje të rëndësishme në historikun e shkurtër të konsolidimit të institucionit të FKGK-së. Ky vit shënon përfundimin e programit të USAID – Fuqizimi i Mbështetjes Kreditore, një program që për tre vjet radhazi shërbeu si inkubator i krijimit të institucionit të FKGK-së.

Me përkrahje nga Qeveria e Republikës së Kosovës, programi i USAID – Fuqizimi i Mbështetjes Kreditore bëri përgatitjet themelore për krijimin e ambientit ligjor të krijimit të institucionit, modeloi shërbimet e skemës garantuese duke iu përshtatur karakteristikave të tregut lokal, njëkohësisht duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare të menaxhimit të riskut kreditor, si dhe u kujdes t'i mbulojë të gjitha shpenzimet operative të nevojshme për ta funksionalizuar FKGK-në. Në sajë të kësaj përkrahjeje dhe të ekspertizës nga kolegët e programit të USAID – Fuqizimi i Mbështetjes Kreditore sot institucioni i FKGK-së funksionon si partner i rëndësishëm dhe i respektuar në procesin e ndërmjetësimit financiar brenda ekonomisë së vendit tonë.

Kontributi në kapital nga KfW-ja në vlerë 7.0 mil. euro, si dhe disbursimi i pjesës së fundit të mjeteve të zotuar si ndihmë në kapital nga Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë (MTI) në vlerë prej 1.0 mil. eurosh ka rezultuar në dyfishimin e kapitalit të institucionit, nga 7.8 mil. euro sa ishte në fund të vitit 2016 në 15.8 mil. euro në fund të vitit 2017. Duke aplikuar një faktor të leverimit të kapitalit, duke u bazuar në analiza të riskut kreditor për tregun e Kosovës, tanimë FKGK-ja ka potencial për të alokuar

limite të garancive deri në 64.0 mil. euro, ndërsa mund të përkrahë aktivitetin kreditor deri në 128.0 mil. euro, vlerë kjo e rëndësishme për të ndikuar në rritjen e kreditimit në sektorin e NMVM-ve, në nivel të sektorit bankar të Kosovës. Në vazhden e bashkëpunimeve me KfW-në, kemi krijuar Agro-Dritaren, skemë garantuese e veçantë në kuadër të FKGK-së, që do të ketë destinim mbështetjen e kreditimit në sektorin e agrobizneseve. Një iniciativë e tillë përveçqë do të ndikojë në inkurajimin e investimeve në sektorin e agrobiznesit, do të na shërbejë edhe si model për të ndërtuar një qasje më proaktive të zhvillimit të produkteve që synojnë segmente të caktuara të klientëve, të konsideruara me rëndësi strategjike për ekonominë e vendit tonë.

Viti 2017 shënoi edhe një ngjarje tjetër të rëndësishme në drejtim të krijimit të partneritetit me donatorët dhe me partnerët ndërkombëtarë. E tillë është arritja e marrëveshjes për garantimin e një pjese të portofolit të garancive të FKGK-së nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), me ndërmjetësim nga Ambasada Suedeze në Kosovë, në vlerë prej 10.0 mil. eurosh. Mbulimi i një pjese të rrezikut të portofolit të garancive nga një institucion me reputacion si është SIDA reflekton besueshmëri dhe seriozitet në treg për shërbimet e ofruara nga FKGK-ja.

Po ashtu viti 2017 ishte edhe një vit tjetër i suksesshëm për sektorin bankar në Kosovë. Edhe këtë vit bankat komerciale në Kosovë, të ndihmuara nga një rregullator i matur i mbikëqyrjes bankare, dëshmuuan gatishmërinë e tyre për të rritur në mënyrë të përgjegjshme aktivitetin kreditor, ndërsa njëkohësisht u kujdesën të përmirësojnë edhe më tej menaxhimin e kualitetit të portofolit kreditor. FKGK-ja si pjesëmarrëse në procesin e ndërmjetësimit financiar vazhdoi ta forcojë partneritetin me sektorin bankar, duke rritur numrin e bankave partnere përfituese nga skema garantuese e FKGK-së. Si rrjedhojë, FKGK-ja tanimë ka marrëveshje kontraktuale me të gjitha bankat që veprojnë në segmentin e NMVM-ve në tregun e Kosovës.

Rezultatet institucionale të FKGK-së reflektohen edhe në trendin inkurajues të rritjes së portofolit kreditor të garantuar, posaçërisht gjatë pjesës së dytë të vitit të kaluar. Vlera kulmuese e portofolit të kredive të garantuara nga skema garantuese e FKGK-së ka

BESNIK BERISHA

Drejt看 menaxhues



arritur në 30 mil. euro, e shpërndarë në 795 kredi, një zhvillim që përmbush pritjet tona për vitin e parë të operimit. Ky aktivitet investues, i mbështetur nga skema garantuese e FK GK-së, ka rezultuar në krijimin e më se 1.203 vendeve të reja të punës në ekonominë e Kosovës.

Sot portofoli ynë ka pjesëmarrje solide të bizneseve të drejtuara nga sipërmarrëset femra, afërsisht 10%, ndërsa është inkurajues niveli i pjesëmarrjes së ndërmarrjeve nga sektori i agrobiznesit dhe i prodhimit, që njëherazi konsiderohen sektorë të rëndësishëm të veçantë për të ndërtuar pavarësinë ekonomike të një vendi përmes zëvendësimit të importeve dhe rritjes së aftësisë eksportuese të një ekonomie nacionale.

Përveç tjerash, përvoja nga viti i kaluar na tregoi se cili segment i klientëve, për nga madhësia dhe për nga faza e zhvillimit të ndërmarrjes, ka më së shumti nevojë për mbështetje nga skema garantuese e FK GK-së. Po ashtu kjo reflektohet në natyrën e klientëve që kanë përfituar nga skema garantuese e FK GK-së, kryesisht i populluar nga ndërmarrje të kategorisë së vogël, me vlerë kreditore mesatare prej 38K euro, ndërsa nga aspekti i maturitetit të zhvillimit të ndërmarrjes gjenden në fazën e hershme të rritjes së aktivitetit të tyre afarist. Historikisht, për këtë kategori të ndërmarrjeve mungesa e kolateralit, shumë aktuale për këtë fazë të zhvillimit të ndërmarrjes, mund të ketë qenë barriera kryesore në realizimin e ideve investuese, që më pastaj do t'u mundësonte rritje të biznesit të tyre. Një përzgjedhje natyrale e kësaj kategorie të klientëve, nga Institucionet Financiare (IF) partnere, për t'u regjistruar në skemën garantuese të FK GK-së na konfirmon edhe një herë që shërbimet tona garantuese favorizojnë atë grup të ndërmarrjeve që paraqesin arsyen kryesore të ekzistencës së FK GK-së.

Në gjithë vazhden e të arriturave gjatë vitit 2017 nuk mund të kalojmë pa përmendur me shumë krenari faktin që iniciativa e nisur nga kooperimi i suksesshëm i donatorëve ndërkombëtarë dhe i Qeverisë së Republikës së Kosovës për krijimin e një institucioni vendor me vlera etike dhe me praktika të shëndosha të qeverisjes korporative, që adreson çështje vitale të ekonomisë dhe të shoqërisë së vendit, ka arritur të menaxhohet për mrekulli nga Bordi i Drejtoreve dhe nga stafi i FK GK-së. Një

qeverisje e shëndoshë korporative, e përbërë nga një bord profesional dhe nga një staf me përvojë, të përkushtuar dhe të motivuar për t'i realizuar objektivat institucionale, janë siguria më e madhe në realizimin e idesë fillestare të donatorëve dhe të themeluesve të FK GK-së. Për këtë arsye falënderojmë angazhimin e anëtarëve të Bordit të Drejtoreve për trasimin e rrugës institucionale gjatë vitit të kaluar, si dhe stafin e FK GK-së për motivin dhe për gatishmërinë e treguar në mobilizimin e gjithë përvojës dhe të energjisë së tyre në implementimin e strategjisë dhe të objektivave institucionale.

Rritja e ndikimit në procesin e ndërmjetësimit financiar përmes rritjes së portofolit të garancive, arritja e vetëqëndrueshmërisë financiare, si dhe fuqizimi i kapaciteteve humane të institucionit do të vazhdojnë të jenë sfidat kryesore jo vetëm gjatë vitit të ardhshëm 2018, mirëpo edhe në vitet që pasojnë. Një aktivitet më dinamik i përdorimit të potencialit garantues të FK GK-së, nga bankat komerciale, posaçërisht tanimë pas rritjes së kapitalit, jo vetëm që do të rezultojë në më shumë investime në ekonomi, mirëpo do të ndikojë pozitivisht edhe në arritjen e qëndrueshmërisë financiare të institucionit. Prandaj, përshtatja e vazhdueshme e ofertës sonë për zhvillimin dinamik të tregut bankar do të jetë shumë e rëndësishme për të vazhduar me trendin e zhvillimit të portofolit, sipas planifikimeve tona.

Për fund, konkludojmë me bindje të plotë që viti 2017 ka qenë vit i suksesshëm për institucionin tonë dhe njëherazi besojmë që ka vendosur themele të qëndrueshme për shumë vite të suksesshme në të ardhmen.

Në emër të FK GK-së i falënderoj edhe një herë donatorët tanë ndërkombëtarë dhe Qeverinë e Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme në ndërtimin e institucionit të FK GK-së. Po ashtu falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit tjerë, mbi të gjitha Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) dhe IF-të partnere për bashkëpunimin dhe për durimin e treguar gjatë viteve të para të operimit të FK GK-së.

AKRONIMET

BD		Bordi i Drejtorëve
BQK		Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
FKGK		Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
IF		Institucioni Financiar
IFJB		Institucionet Financiare Jobankare
IFR		Institucion Financiar i Regjistruar
IFRS		Standardi Ndërkombëtar për Raportim Financiar
IMF		Institucionet Mikrofinanciare
KfW		Banka Zhvillimore Gjermane
KJP		Kreditë Jperformuese
KMR		Komiteti për Menaxhim të Riskut
KA		Komiteti i Auditimit
MF		Ministria e Financave
MTI		Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë
NMVM		Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme
QRK		Qeveria e Republikës së Kosovës
SIDA		Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
SMMS		Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
SHBK		Shoqata e Bankave të Kosovës
USAID		Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBLEDHJE E TREGUESVE FINANCIARË

TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË	DHJETOR 2016	DHJETOR 2017
KAPITALI	7,345,141	15,790,921
Potenciali garantues	36,725,705	63,954,606
Limitet e alokuara	27,500,000	30,000,000
Shkalla e shfrytëzimit të limiteve nga IFR-të partnere	6.70%	38.90%

BILANCI I GARANCIVE	1,848,846	11,657,827
Nr. i kredive aktive të garantuara	86	738
Nr. i IF partnere	6	7
Mesatarja e garancive	24,813	18,399
Mesatarja e maturitetit	26	35
KJP (në %)	0.00%	0.20%
Mbulueshmëria e KJP-s me provizione (në %)	0.00%	341.00%

KAPITALI I INVESTUAR	-	8,500,000
----------------------	---	-----------

Vlerat monetare janë në euro.

PJESA 2





PROFILI I INSTITUCIONIT

THEMELIMI I FKGGK-SË DHE STATUSI I SAJ

Fondi Kosovari për Garanci Kreditore është institucion i pavarur, i cili u lëshon garanci institucioneve financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e NMVM-ve.

FKGGK-ja është themeluar në janar të vitit 2016, duke u bazuar në Ligjin për Themelimin e Fondit Kosovari për Garanci Kreditore.

Ligji themelues i FKGGK-së është iniciuar nga MTI-ja, ndërsa zhvillimi i tij është përkrahur nga USAID-i në Kosovë përmes programit Fuqizimi i Mbështetjes Kreditore dhe Banka Zhvillimore Gjermane (KfW). Ligji ka hyrë në fuqi më 23 janar 2016.

MISIONI

Fondi Kosovari për Garanci Kreditore është entitet juridik i pavarur me karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditore për NMVM-të, duke ndarë riskun kreditor me institucionet financiare.

Përmes garantimit të portofolit kreditor të institucioneve financiare ne synojmë rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë, mbështetjen e prodhimit vendor dhe të atyre shërbimeve të cilat krijojnë vlerë të shtuar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbështetjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.

Ne jemi të përkushtuar ndaj menaxhimit të qëndrueshëm korporativ dhe ndaj përgjegjësisë sociale që vjen me të. Duke i koordinuar aktivitetet me partnerët tanë: donatorët, institucionet financiare dhe rregullatorët lokalë, mundohemi t'u shërbejmë interesave afatgjate ekonomike të vendit, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë sonë në përgjithësi.



VLERAT INSTITUCIONALE

Vlerat institucionale të FK GK-së, të cilat frymojnë brenda institucionit, si dhe shërbejnë për ndërtimin e praktikave të përditshme në punë, sigurojnë udhërrëfim që aktivitetet tona do të kenë një nivel të lartë të përgjegjshmërisë dhe do të jenë në përputhje me standardet më të larta etike.

Transparenca: Duke qenë institucion në interes publik, FK GK-ja konsideron si shumë të rëndësishme shpalosjen e informacionit lidhur me praktikën e punës, politikat dhe rezultatet financiare e operative me partnerët, me palët e tjera të interesit, si dhe me publikun e gjerë.

Partneriteti dhe bashkëpunimi: Ndërtimi i marrëdhënieve të shëndosha, duke u bazuar në transparencë dhe në përgjegjshmëri me partnerët tanë, ndihmon në arritjen e objektivave të përbashkëta, ndërtim të besueshmërisë dhe respekt të ndërsjellë.

Objektiviteti dhe pavarësia në vendimmarrje: FK GK-ja ruan objektivitetin dhe pavarësinë në vendimmarrje, duke u bazuar në arsye dhe në parime të shëndosha, duke nxitur zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit financiar.

Përkushtimi: Punonjësit e FK GK-së me përkushtim dhe me profesionalizëm mundohen të realizojnë misionin dhe objektivat e saj, duke besuar në rolin dhe në ndikimin pozitiv, që institucioni do ta ketë në zhvillimin e shëndoshë ekonomik.

Puna ekipore dhe profesionalizimi në punë: FK GK-ja ka një ekip ekspertësh, të cilët bashkëpunojnë mbi bazat e respektit të ndërsjellë. Puna ekipore për zgjidhjen e problemeve dhe të iniciativave, komunikimi i hapur dhe ndarja e përvojave profesionale në mes vete janë bazamenti i suksesit të FK GK-së. Integriteti dhe dinjiteti personal janë vlera që e përcjellin secilin punëtor në vazhden e realizimit të detyrave dhe të iniciativave në punë, pa bërë asnjë kompromis në këto parime.



PJESA 3



The background features a large teal triangle on the right side, pointing towards the top right corner. On the left side, there is a grey trapezoidal shape. The text is positioned in the lower-left area of the teal triangle.

QEVERISJA
KORPORATIVE

BORDI I DREJTORËVE DHE PERSONELI

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, përmes legjislacionit përkatës, qeveriset nga një Bord Drejtorësh në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:

- A) Një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare i emëruar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- B) Një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare i emëruar nga Ministria e Financave
- C) Katër (4) anëtarë të emëruar nga donatorët ndërkombëtar, dhe
- D) Drejtori Menaxhues i FK GK

ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE TË FK GK-SË NË VITIN 2017:



KRESHNIK KURTISHI,
USHTRUES DETYRE I KRYESUESIT TË BORDIT
Zëvendës drejtor i projektit të USAID-it "Partneritet për zhvillim"



BESNIK BERISHA
Drejtor menaxhues i FK GK-së



BESIAN MUSTAFA
Drejtor i përgjithshëm, Agjencia për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, Qeveria e Republikës së Kosovës



SALVADOR ELMAZI
Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Qeveria e Republikës së Kosovës

PERSONELI I FKGK-SË:

ARTA KRASNIQI

Këshilltare e përgjithshme dhe sekretare e Bordit të Drejtorëve

BESNIK BERISHA

Drejtor Menaxhues

VJOSA KELMENDI

Menaxhere e lartë e Financave dhe e Administratës

ALBAN KASTRATI

Menaxher i lartë i Riskut


NORA ARIFI

Menaxhere e lartë e Garancioneve

Nga e majta në të djathtë.



STRUKTURA ORGANIZATIVE



KOMITETET

Komiteti i Menaxhimit të Riskut

Komiteti për Menaxhimin e Riskut është themeluar në bazë të Ligjit për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Komiteti i Menaxhimit të Riskut ndihmon Bordin e Drejtorëve me fokus të specializuar në fushën e menaxhimit të riskut. Komiteti mblidhet së paku në baza tremujore dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë të Bordit, përderisa menaxheri i lartë i riskut është pjesëmarrës i përhershëm i Komitetit.

Si i tillë, Komiteti shqyrton politikat e riskut kreditor dhe operativ, mbikëqyr zhvillimet e portofolit të garantuar dhe siguron që profili i riskut kreditor është në përputhshmëri me politikat kreditore, me ligjet dhe me rregulloret e zbatueshme.

Komiteti i Auditimit

Komiteti i Auditimit është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Komiteti përbëhet nga tre anëtarë të Bordit, të përcaktuar nga vetë Bordi i Drejtorëve. Komiteti i Auditimit mblidhet në baza tremujore. Takime të veçanta mund të mbahen në mes të takimeve të planifikuara nëse konsiderohet e nevojshme nga kryesuesi i Komitetit.

Komiteti i Auditimit është përgjegjës për dhënien e rekomandimeve Bordit të Drejtorëve për çështjet e menaxhimit të rrezikut, të kontrollit të brendshëm, të pasqyrave financiare, të kërkesave të pajtueshmërisë, të auditimit të brendshëm, të auditimit të jashtëm dhe të funksioneve të tjera relevante të qeverisjes së FKGK-së. Përveç kësaj, Komiteti i Auditimit rishikon kontrollet e brendshme financiare, operative dhe administrative. Mbikëqyr përputhjen e FKGK-së me politikat e me procedurat dhe monitoron përputhshmërinë me ligjet dhe me rregulloret në fuqi. Shqyrton raportet financiare dhe rekomandon emërimin e Auditorit të Jashtëm. Monitoron performancën e Auditorit të Jashtëm, shqyrton raportin e Auditorit të Jashtëm mbi pasqyrat financiare të FKGK-së dhe raporton gjetjet në Bordin e Drejtorëve.

BASHKËPUNËTORËT E FK GK-SË

Për t'i arritur objektivat dhe synimet FK GK-ja bashkëpunon me institucionet financiare (bankat, IMF-të, IBBF-të), me donatorët, me Qeverinë e Kosovës, me Bankën Qendrore të Kosovës dhe me Komunitetin e NMVM-ve.

DONATORËT

- Qeveria e Republikës së Kosovës
- Banka Zhvillimore Gjermane KfW
- Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)

BASHKËPUNËTORËT

- Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – Sida përfaqësuar nga Ambasada Suedeze

INSTITUCIONET FINANCIARE TË REGJISTRUARA

- Banka Ekonomike
- Banka Kombëtare Tregtare
- Banka për Biznes
- NLB Banka
- ProCredit Bank
- Raiffeisen Bank
- TEB



PJESA 4





PERFORMANCA E FKGGK-së

STRUKTURA E KAPITALIT DHE INVESTIMET


Kapitali i FKKG-së përbëhet nga kapitali i dhuruar ose nga fondet që i jepen FKKG-së nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Në vitin 2016 vlera e kapitalit të dhuruar të FKKG-së ishte 7,345,141 euro, ndërsa gjatë vitit 2017 kjo vlerë është dyfishuar, duke mbyllur vitin 2017 me kapital të dhuruar në vlerën 15,790,921 euro.

Dyfishimi i kapitalit është si rezultat i kontributit nga donacionet e USAID-it, të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të KfW-së së fundi në dhjetor 2017.

DONATORËT	FONDET E DHURUARA 2016	FONDET E DHURUARA 2017	GJITHSEJ	%
QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	2,000,000	1,000,000	3,000,000	19%
USAID	5,345,141	445,780	5,790,921	37%
KFW	-	7,000,000	7,000,000	44%
Gjithsej	7,345,141	8,445,780	15,790,921	100%

Vlerat monetare janë në euro.



FKGK-ja leveron (multiplikon) kapitalin e saj pesë (5) herë, ndërsa kapitalin e dedikuar për Agro dritaren e leveron dy (2) herë. Ky limit siguron që FKGK-ja do të ketë kapital të mjaftueshëm për të kryer aktivitetin e saj dhe për t'i absorbuar humbjet e mundshme.

Fondi ka arritur kapacitetin të garantojë afër 64 mil. euro dhe duke marrë parasysh që mbulueshmëria maksimale është 50% e kredisë së lëshuar nga Institucioni Financiar i Regjistruar, kjo përkthehet në 128 mil. euro kredi potenciale të lëshuara në tregun tonë, duke ndikuar në lehtësimin e qasjes në financa dhe zhvillimit të NMVM-ve.

Rritja e shumës së garancive të lëshuara, si një ndër dy burimet kryesore të financimit të institucionit, ndikon po ashtu në të hyrat e FKGK-së dhe rrjedhimisht në vetëqëndrueshmërinë e institucionit.

Rritja e kapitalit të dhuruar ka ndikim direkt në dy burimet kryesore të financimit të FKGK-së. Burimi tjetër kryesor i financimit për FKGK-në është edhe interesi ose të ardhurat nga investimet e kapitalit të FKGK-së.

Fondi i kapitalit të FKGK-së investohet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe për


Politikën e Investimit, të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, për të mbrojtur kapitalin e FKGK-së dhe në këtë mënyrë për t'i mbështetur garancitë, po ashtu edhe për të gjeneruar të hyra mbështetëse për qëndrueshmërinë e FKGK-së dhe për të ruajtur likuiditetin adekuat.

Menaxhimi efektiv i riskut të likuiditetit është thelbësor për të ruajtur besimin e donatorëve dhe IF-të partnere, si dhe për të mundësuar që veprimtaria bazë të vazhdojë të gjenerojë të ardhura, edhe në rrethana të pafavorshme.

FKGK-ja është angazhuar në përdorimin e teknikave të përshtatshme të matjes së performancës që balancojnë rrezikun dhe shpërblimin brenda kontekstit të administrimit efektiv të riskut. Për qëllimet e optimizimit të kthimeve potenciale brenda parametrave të pranueshëm të riskut FKGK-ja ka përgatitur një politikë investimi që përcakton qartë strukturën e investimeve në përputhje me mandatin e FKGK-së dhe të objektivave të tij strategjike.

Gjatë vitit 2017 FKGK-ja ka investuar 8,500,000 euro në IF-të e regjistruara në FKGK, kryesisht me maturitet njëvjeçar. Mjetet e pranuar si kapital i dhuruar nga KfW-ja në fund të vitit 2017 planifikohet të investohen gjatë fillimit të vitit 2018 në Institucionet e Regjistruara Financiare, duke rritur kështu bashkëpunimin edhe në këtë sferë.

INVESTIMET



Të ardhurat nga investimet dhe nga tarifat e garancive FKGK-ja i shfrytëzon për t'i mbuluar shpenzimet e veta operative dhe kostot e pagesës së humbjeve mbi garancitë kreditore. Çdo tepëricë e mbledhur e tarifave që tejkalon shpenzimet operative dhe humbjet eventuale kreditore mbahet në FKGK për qëllime të funksionimit të tij dhe nuk shpërndahet jashtë FKGK-së në asnjë formë ose mënyrë, duke përfshirë edhe dividendin.

ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE


Rritje e moderuar me cilësi të lartë

FKGK-ja ka filluar të pranojë kredi për garanci nga IF-të në fund të shtatorit 2016. Aktiviteti i saj gjatë vitit 2017 u zgjerua, duke përfshirë të gjitha bankat e rëndësishme në marrëveshje të garancisë.

Ndonëse kemi të bëjmë me një portofol të ri, portofoli i garancive i FKGK-së në vitin 2017 karakterizohet me rritje dhe me cilësi të lartë. FKGK-ja gjatë 2017-s ndërmjetësoi në kredidhënien me vlerë prej 25.5 mil. eurosh për 700 NMVM, të mbështetur nga një shumë garancie prej 12.3 mil. eurosh, duke arritur shumën kumulative të kredive të miratuara në vlerë prej 30 mil. eurosh për 785 NMVM, të mbështetur nga një shumë garancie prej 14.4 mil. eurosh.


KREDITË E APROVUARA

(shuma kumulative)



Vlera totale e mbetur e portofolit të kredive, të miratuara për garanci në fund të vitit 2017, ishte 24.2 mil. euro dhe e shpërndarë në 738 kredi, përderisa vlera totale e mbetur e portofolit të garantuar ishte 11.6 mil. euro.

PORTOFOLIO AKTIVE



Maturiteti mesatar dhe vlera mesatare e kredisë

Vlera mesatare e kredisë për klient në fund të vitit ishte afër 40.000 euro, vlerë e cila përputhet me kategorinë e vogël të ndërmarrjeve të cilat kanë mungesë të kolateralit, andaj edhe nevojë për mbështetje të garancisë kreditore.

Portofoli i garantuar përbëhet nga kredi afatmesme me një mesatare prej 36 muajsh, përderisa frekuenca e pagesave është pothuajse 85% me këste të rregullta mujore.

Rreth 87% e NMVM-ve janë ndërmarrje me më pak se 10 punëtorë

Portofoli i garantuar kryesisht është i përbërë nga ndërmarrjet mikro. Përqendrimi i portofolit të garantuar sipas numrit të punëtorëve (Definimi i përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-031, si dhe në Ligjin për Themelimin e FKGK-së) është:


KATEGORITË	KRITERET	TOTALI
Mikro	deri 9	87%
E vogël	10 - 49	12%
E mesme	>50	1%

Një distribuim i tillë i portofolit të garancisë kreditore përshtatet me orientimin tonë drejt segmenteve të ndërmarrjeve komerciale (ndërmarrje mikro dhe të vogla), që përbëjnë pjesën më të madhe të sektorit privat të vendit tonë.

Gamë e gjërë e sektorëve të ekonomisë përfituese të garancioneve

Në fund të periudhës së raportimit, portofoli i garancisë kreditore ishte i shpërndarë nëpër një gamë të gjerë të sektorëve të biznesit. Sektori më dominues ishte ai i tregtisë me pakicë dhe me shumicë me 41%, i vijuar nga shërbimi me 26%, prodhimi me 19%, bujqësia me 9% dhe ndërtimtaria me 5%.

KREDITË SIPAS SEKTORIT



Shpërndarja e portofolit të FK GK-së në sektorë të ndryshëm ka vazhduar për të ndjekur trendin e njëjtë, i cili dominon në ekonominë e vendit.


Ndonëse sektori i bujqësisë ka vazhduar të ketë pjesëmarrje të ulët diku në 4% në gjithsej sektorin bankar, kjo pjesëmarrje në gjithsej portofolin e FK GK-së ishte 9%.

Duke pasur një nga objektivat tona stimulimin e sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë mbetet që të punohet edhe më tepër në fuqizimin e ndërmarrjeve prodhuese dhe të agrobizneseve, ndërmarrje të cilat janë forca lëvizëse të ekonomisë dhe kontribuues në rritje të punësimit dhe në ngritjen e mirëqenies sociale në përgjithësi.



Investimet kapitale, me dominim më të lartë


27% e kredive të aprovuara më 2017-n ishin investuar në pajisje (makineri të prodhimit, pajisje bujqësore, pajisje të tjera); 23% në tokë, në ndërtim ose në rinovim; 37% për kapital pune dhe 13% në të tjera.



Investimet në asete fikse (pajisje dhe ndërtim/renovim/tokë), të cilat janë gjeneruese të të ardhurave, dominuan portofolin e garantuar gjatë vitit 2017. Po ashtu investimet në kapital punues të rëndësishme për të zgjeruar biznesin kishin pjesëmarrje domethënëse në portofolin e garantuar.

Shfrytëzimi i garancive në regjione të ndryshme

Në 2017-n me një pjesëmarrje prej 44% regjioni i Prishtinës kishte participimin më të madh në portofolin e kredive të vëna nën garanci.



Vlerat monetare janë në euro.

Krijimi i vendeve të reja të punës

Krijimi i vendeve të reja të punës është një nga objektivat kryesore të themelimit të FK GK-së. 700 kredi për NMVM-të gjatë 2017-s parashikuan 944 vende të reja pune. Këto vende të reja të punës vijnë kryesisht nga sektorët tregti dhe shërbime rreth 68%.

PUNËSIME TË REJA

944

78

BUJQËSI, PYLLTARI
DHE PESHKATARI

299

SHËRBIME

139

PRODHIMTARI

83

NDËRTIMTARI


345

TREGTI
ME SHUMICË
E PAKICË





SHPËRNDARJA E PORTFOLIOS SIPAS GJINISË



Kreditë për gratë në biznes

Gratë sot participojnë me një shkallë të ulët të kredimarrjes formale në raport me burrat, duke qenë të detyruara që një pjesë të financimit për bizneset e tyre ta marrin nga financimet joformale. Kjo ndërlidhet mu me mungesën e kolateralit, duke qenë që vetëm 15% e tyre kanë pronë të regjistruar në emër të vet.

Pikërisht për këtë FKGK-ja ka vënë, si një nga objektivat institucionale të rëndësishme, mundësi më të mira për sektorët dhe për kategoritë më pak të shërbyera ekonomike dhe të popullsisë, duke përfshirë gratë.

Gjatë vitit 2017 nga 700 kredi për NMVM-të, 11% janë lëshuar për gra pronare/bashkëpronare në biznes.

MENAXHIMI I RREZIKUT KREDITOR

Menaxhimi i rrezikut kreditor i është përshtatur veprimtarisë së FK GK-së, i cili nënkupton që FK GK-ja nuk merret drejtpërdrejt me kredimarrësin, por që FK GK-ja bën garantimin e pjesshëm të kredive të NMVM-ve të lëshuara nga IF-të e regjistruara në FK GK.

Meqenëse FK GK-ja nuk merret drejtpërdrejt me kredimarrësin, ajo ka zhvilluar mekanizmat ex-ante dhe ex-post për të siguruar përmbushjen e kushteve të saj. Andaj, kujdes të shtuar në menaxhimin e rrezikut i është dhënë përcaktimit të kriterëve për regjistrim të IF-ve, ndarjes së limiteve, si dhe kriterëve kualifikuese të kredive. Kjo qasje nënkupton që në procesin e regjistrimit dhe të ndarjes së limiteve FK GK-ja bën vlerësim të thukët, si dhe krijon mekanizmat për kontrollimin dhe monitorimin e kredive dhe të IF-ve.

Në përputhje me këto udhëzime, gjatë vitit 2017 FK GK-ja shqyrtoi dhe miratoi kërkesën për regjistrimin e një IF-je, si dhe u mor me rivlerësimin e limiteve të disa IF-ve të regjistruara. Përpos kësaj, gjatë vitit të kaluar FK GK-ja zhvilloi praktikën e mbledhjeve të rregullta mujore, ku analizohen trendet në sektorin bankar në përgjithësi, si dhe në veçanti për secilën IF, si dhe me analizën e portofolit të garantuar. Mbikëqyrja dhe analiza e këtyre trendeve përbëjnë njërin prej kompetencave më të rëndësishme të FK GK-së, e cila do të mundësonte identifikimin e problemeve potenciale dhe menaxhimin e tyre në fazë të hershme.

Me qëllim të mbulimit të humbjeve që mund të paraqiten nga garancitë e thirrura, FK GK-ja gjatë vitit 2017 vazhdoi provizionimin e garancive sipas IFRS 9 (Standardit Ndërkombëtar për Raportim Financiar 9). FK GK-ja bën zhvlerësimin e garancive në tri faza, ku çelësi për ndryshim është klasifikim kreditor i klientit, të dhëna të cilat pranohen në baza mujore nga IF-të e regjistruara.


Meqenëse të dhënat historike të FK GK-së janë mjaft të shkurtra, modeli i humbjeve të pritura është zhvilluar nga të dhënat e tregut, respektivisht nga të dhënat e IF-ve të regjistruara. Sipas modelit të ndërtuar, mbulueshmëria e KJP-së në dhjetor 2017 ishte 341%, përderisa mbulueshmëria në sektorin bankar ishte 150%, që rezulton se FK GK-ja ka ndërtuar një qasje mjaft më konservative me aspektin e provizionimit.

Kualiteti i portofolit

Në vitin e dytë të operimit portofoli i FK GK-së ka pasur një rritje të konsiderueshme duke mbajtur një nivel të dëshirueshëm të KJP-së, si dhe pa ndonjë kërkesë nga bankat për pagesën e kredive të humbura.


Më 31 dhjetor 2017, KJP-ja në portofolin e garantuar ishte 0,22%, ndërsa niveli i kredive delikuede ishte 0,42%.

PËRFORMANCA SIPAS KUALITETIT KREDITORE



Pavarësisht kualitetit të mirë të portofolit, FK GK-ja vijoi ndërtimin e rezervave të provizionimit sipas modelit të humbjeve të pritura. Sipas këtij modeli të provizionimit, mbulueshmëria e gjithsej portofolit të garantuar ishte 0,76%, përderisa mbulueshmëria e KJP-së ishte 341%.

BILANCI I GARANCIONEVE SI DHE REZERVAT E PROVIZIONIMIT (SIPAS KLASIFIKIMIT KREDITOR)



RISIA E 2017-s – SIDA

Në vitin 2017 FK GK-ja nënshkroi marrëveshjen për rigarantim të portofolit me Agjencinë SIDA, në vlerë 10.0 mil. euro. Marrëveshja ofron mundësi të transferimit të riskut kreditor deri në 50% të vlerës së kryegjësë në pjesën e garantuar të kredive nga FK GK-ja. Kjo formë e mbulimit të portofolit të garancive ndaj një pjese të riskut kreditor paraqet një mundësi më shumë për rritjen e kapacitetit garantues të FK GK-së, duke u bazuar në kapitalin ekzistues.


Mënyra se si funksionon një skemë rigarantuese është e ngjashme me mënyrën se si ne e garantojmë portofolin e IF-ve të regjistruara në FK GK. Më konkretisht, marrëveshja midis FK GK-së dhe SIDA-s funksionon në këtë mënyrë: SIDA si palë garantuese mbulon 50% të riskut të kredive të reja të garantuara nga FK GK-ja (pala e garantuar), ndërsa të shpërndara nga bankat partnere, deri në limitin 40.0 mil. euro. E gjithë kjo bëhet në kompensim të një komisioni si kundërvlerë për riskun e marrë nga pala garantuese.

Kjo marrëveshje është arritur duke i falënderuar ndërmjetësimin të Ambasadës Suedeze në Kosovë, e cila përveç

mbështetjes së negociatave midis SIDA-s dhe FK GK-së ka treguar vullnet të mbulojë një pjesë të shpenzimeve të komisionit nga vlera fillestare bazë, që ka rezultuar nga kuantifikimi financiar i riskut kreditor në tregun e NMVM-ve në Kosovë. Në sajë të mbështetjes nga Ambasada Suedeze në mbulimin e një pjese të shpenzimeve, FK GK-ja realizon këto shërbime me kushte shumë të favorshme.

Sa i përket zhvillimit institucional, kjo do të thotë më shumë besim ndaj FK GK-së dhe besim në tregun bankar për shërbimet e garancive të kredive të ofruara nga ne, ndërsa nga aspekti operativ përfitimi kryesor është shpërndarja e rrezikut të kredisë dhe më shumë potencial garantues, duke u bazuar në kapitalin ekzistues.

Kjo marrëveshje do të përshpejtojë edhe më shumë rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, rrjedhimisht më shumë investime në sektorin privat, më shumë aftësi konkurruese për ndërmarrjet kosovare, përmirësim të bilancit tregtar, më shumë punësim dhe në përgjithësi më shumë zhvillim ekonomik.



AGREEMENT

Purchase from the owner (hereinafter "Seller") the
in the city State
description of which

1. Purchase Price and Conditions of Payment The
Dollars (\$)
below: A. Cash Subject to
shall be paid in cash at the time of closing the sale. B. Cash Subject to
shall be paid in cash at the time of closing the sale subject
days after the
payable in not less than
to the amount of \$
to the amount of \$
interest at a rate specified above then either Purchaser
money deposited by Purchaser will be
not be obtained within the time specified by Purchaser
and any earned interest. The purchase price shall be paid in cash
Subject to Existing Mortgage. The purchase price the then outstanding balance
existing mortgage in favor of
of such mortgage debt is approximately
20. D. Cash With Assumption of Existing
at the time of the closing of the sale after
attached hereto and (D. Cash
purchase price the then outstanding balance due and
dated
purchase price the then outstanding balance due and
dated
of Existing Mortgage. The purchase price shall be paid in cash at the time of the closing of the sale after
after deducting from the purchase price the then outstanding balance due and owing under the existing
a present balance of approximately \$
20. which the purchaser hereby assumes and agrees to pay in accordance
and to perform all of its provisions, purchaser shall pay any and all payments owing
the closing of the sale. Any transfer fees required by the mortgage shall be paid

(PURCHASER)
(PURCHASERS)



PJESA 5



AKTIVITETET GJATË 2017-s

LIDHJA E MARRËVESHJEVE TË REJA

Fondi nënshkroi marrëveshjen për rritje të limitit për garanci me Bankën për Biznes



16 qershor 2017

BPB-ja është një ndër bankat e para, e cila nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë me FKKG-në dhe e cila e shfrytëzoi limitin e alokuar në tërësi.

Marrëveshja për limitin e ri synon të zgjerojë tutje kredidhënien për bizneset kosovare, të kontribuojë në krijimin e vendeve të punës, në rritjen ekonomike, si dhe në rritjen e mundësive për sektorë ekonomikë, si: gratë, pakicat, bujqit, ndërmarrësit dhe rininë.

FKKG-ja nënshkroi marrëveshje me Bankën Tregtare Kombëtare, Dega në Kosovë



16 qershor 2017

Marrëveshja do t'i mundësojë Bankës të përfitojë më shumë siguri kolaterali për kreditë e lëshuara për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të), duke ofruar kështu qasje më të lehtë në financa për kompanitë kosovare. BTK-ja është banka e shtatë, e cila ka nënshkruar Marrëveshjen e Garancisë me FKKG-në.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Garancisë mes FK GK-së dhe SIDA-s



6 dhjetor 2017

FKGK-ja nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë në vlerë prej 10 mil. eurosh me Agjencinë SIDA, e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze, në dhjetor të vitit 2017.

Mbështetja e portofolit të garantuar të FK GK-së nga SIDA ka synim për të rritur edhe më tej aftësinë e Fondit për të siguruar nivel më të lartë të garancive për kredi, duke shënuar njëherësh një qëndrueshmëri edhe më të lartë për sektorin financiar. Një qëndrueshmëri e tillë do të reflektojë në lehtësi për ndërmjetësim financiar, duke ndikuar njëherësh pozitivisht në lehtësimin dhe në nxitjen e kreditimit të NMVM-ve, në rritjen ekonomike, si dhe në punësimin në Kosovë.

FKGK-ja nënshkroi marrëveshje me KfW-në, e përkrahur nga Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim



6 dhjetor 2017

Marrëveshja prej 7.45 milionë eurosh parasheh kontribut në kapitalin e përgjithshëm të FK GK-së për skemën bazike garantuuese me vlerë prej 2 milionë eurosh, si dhe 5.45 milionë euro për lansimin e Agro-Dritares.

Prej kësaj vlere 450 mijë euro do të shkojnë në asistencë teknike. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve do të rrisë kontributin drejt zhvillimit të portofolit të garancisë dhe arritjes së qëllimeve të Fondit.

PUNËTORITË/SEMINARET

FKGK-ja dhe Shoqata e Bankave të Kosovës organizuan një takim me bankat



18 tetor 2017

FKGK-ja së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës (SHBK) organizuan një punëtori me IF-të partnere të FKGK-së.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej për rolin e skemave garantuese, për implementimin e Marrëveshjes së Garancisë, për ndikimin e Fondit në aktivitetin e kredithënies, si dhe për zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

Si rrjedhojë e këtij takimi u iniciuan disa analiza dhe vendime sa i përket ngritjes së efijencës dhe avancimit të shërbimeve.

FKGK-ja, USAID-i dhe SHBK-ja organizuan një takim me agrobizneset



9 nëntor 2017

Tryeza e rrumbullakët e IF-ve dhe e agrobizneseve kishte për qëllim nxitjen e diskutimit mes palëve të ndërlidhura në mënyrë që të identifikohen barrierat, të cilat pengojnë kreditimin në këtë sektor.

Diskutimet nxorën konkluzione të rëndësishme për të cilat pjesëmarrësit u zotuan t'i trajtojnë në mënyrë që të rritet qasja në financa për këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë.

ANALIZAT PËR NGRITJE TË EFIÇIENCËS DHE PËRMIRËSIM TË KUALITETIT TË SHËRBIMEVE

Definimi i NMVM-ve

Për të reflektuar lidhur me karakteristikat e shërbimit të garancisë në raport me përqendrimin e portofolit të garantuar në kategori të ndryshme të klientëve, FK GK-ja bëri një hulumtim lidhur me definimin e ndërmarrësisë në Kosovë, si dhe në IF-të partnere, në përqendrimin e portofolit të garantuar në kategori të caktuara, si dhe barrierat e mundshme të cilat do të na mundësonin të japim rekomandime specifike, në mënyrë që t'i arrijmë objektivat institucionale.

Një ndër rekomandimet ishte edhe ngritja e limitit të ekspozimit maksimal për NMVM-të, të cilat mund të kualifikohen në skemën garantuese të FK GK-së.

Anketimi i IFR-ve

Për të fituar një njohuri më të thellë rreth funksionimit të FK GK-së është bërë anketimi i IF-ve të regjistruara në FK GK.

Si rrjedhojë e këtij anketimi u nxor një raport, i cili flet lidhur me aktivitetin e FK GK-së, me shfrytëzueshmërinë, me përparësitë dhe me sfidat ose me çështjet operative që duhen adresuar.

Studimi rreth implementimit të sistemit të menaxhimit mjedisor dhe social

Studimi rreth implementimit të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) nga IF-të partnere kishte për qëllim të identifikonte nivelin e implementimit të SMMS-së, si dhe duke u mbështetur në përvojat e IFR-ve e përvojat lokale të përpilojmë një politikë lidhur me menaxhimin e ndikimit të huadhënies në mjedis.

Një politikë e tillë do të jetë në linjë me përpjekjen e institucionit tonë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik me përgjegjësi të plotë për mjedisin dhe për shoqërinë.

TAKIMET E BORDIT TË DREJTORËVE DHE TË KOMITETEVE PËRKATËSE

Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve të FKGK-së

Gjatë vitit 2017 Bordi i Drejtorëve i FKGK-së mbajti gjithsej gjashtë (6) mbledhje, nga të cilat katër ishin mbledhje të rregullta dhe dy mbledhje të jashtëzakonshme. Nga muaji korrik Bordi mbeti pa një anëtar për shkak të tërheqjes së njerit nga anëtarët e pavarur të bordit. Nga këto mbledhje Bordi nxori vendime strategjike lidhur me mbarëvajtjen e institucionit dhe lidhur me miratimin e propozimeve të prezantuara nga menaxhmenti i FKGK-së.

Mbledhjet e Komitetit për Menaxhim të Riskut Kreditor dhe të Komitetit të Auditimit

Gjatë vitit 2017 Komiteti për Menaxhim të Riskut Kreditor (MRK) dhe Komiteti i Auditimit (KA) mbajtën gjithsej nga tri mbledhje të rregullta. Në këto takime komitetet përkatëse nxorën vendime dhe rekomandime për miratim përfundimtar nga Bordi i Drejtorëve i FKGK-së.

Tabela në vijim paraqet mbledhjet e Bordit dhe të komiteteve ndihmëse të Bordit të Drejtorëve të FKGK-së:

NUMRI I MBLEDHJEVE TË BORDIT	ORARI I MBLEDHJEVE TË BORDIT	PJESËMARRJA E ANËTARËVE TË BORDIT	NUMRI I TEMAVE TË DISKUTUARA	NUMRI I VENDIMEVE TË MARRA
1.	Shkurt 2017	6/6	8	5
2.	Prill 2017	4/6	3	1
3.	Maj 2017	6/6	13	7
4.	Korrik 2017	5/6	13	4
5.	Gusht 2017	5/6	6	2
6.	Tetor 2017	5/6	15	4
		Gjithsej:	58	23

NUMRI I MBLEDHJEVE TË KOMITETIT PËR MENAXHIM TË RISKUT (KMR)	ORARI I MBLEDHJEVE I KMR-SË	PJESËMARRJA E ANËTARËVE TË KMR-SË	NUMRI I TEMAVE TË DISKUTUARA	NUMRI I VENDIMEVE/I REKOMANDIMEVE TË MARRA
1.	Prill 2017	2/3	7	5
2.	Korrik 2017	3/3	8	1
3.	Tetor 2017	3/3	2	7
		Gjithsej:	17	13

NUMRI I MBLEDHJEVE TË KOMITETIT TË AUDITIMIT (KA)	ORARI I MBLEDHJEVE I KA-SË	PJESËMARRJA E ANËTARËVE TË KA-së	NUMRI I TEMAVE TË DISKUTUARA	NUMRI I VENDIMEVE/I REKOMANDIMEVE TË MARRA
1.	Prill 2017	3/3	7	3
2.	Korrik 2017	2/3	5	2
3.	Tetor 2017	2/3	5	2
		Gjithsej:	17	7

PJESA 6



The background of the page is composed of two main geometric shapes. A large teal triangle occupies the bottom right portion, pointing towards the top right corner. To its left, a grey triangle points towards the top left corner. The remaining space is white.

PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA

**FONDI KOSOVAR PËR GARANCI
KREDITORE**

**Raporti i Auditorëve të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin që ka
përfunduar më 31 Dhjetor 2017**

PËRMBAJTJA

	FAQE
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	3
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e Ndryshimeve në Bilancin e Fondit	5
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	6
Shënimet e Pasqyrave Financiare	7 - 21

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Drejtorëve të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore

Raport i auditimit të Pasqyrave Financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore ("Fondi" apo "FKGK"), që përfshinë: Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2017, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar dhe shënimet e pasqyrave financiare, duke përfshirë edhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Fondit më 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që kanë përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuadojë Fondin apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreze, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushtet që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësimi i prezantimit në përgjithësi, strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare, duke përfshirë informatat e paraqitura, si dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në atë mënyrë që përbënë prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Ky raport në Shqip është version i përkthyer i origjinalit në gjuhën Angleze, në rast të mospërputhjeve, origjinali në Anglisht do të mbizotëroj.

BDO Kosova L.L.C.

12 Qershor 2018

Rr. Perandori Justinian, Nr.120


10 000 Prishtinë, Kosovë

BDO KOSOVA L.L.C.


Fondi Kosovar Për Garanci Kreditore
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2017

Shënimet	Më 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (EUR)
ASETET		
Asetet qarkulluese		
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4 7,567,694	7,379,611
Depozitat	5 8,500,000	-
Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera	6 151,665	8,209
Total asetet qarkulluese	16,219,359	7,387,820
Asetet jo-qarkulluese		
Prona, impiantet dhe pajisjet	7 25,939	-
Asetet e paprekshme	8 52,600	-
Total asetet jo-qarkulluese	78,539	-
TOTALI I ASETEVE	16,297,898	7,387,820
DETYRIMET DHE EKUITETI		
Detyrimet afatshkurtra		
Të hyrat e shtyra nga tarifa e garancisë	166,635	35,609
Rezervat e humbjeve nga garancionet e kredive	88,514	10,219
Të hyrat e shtyra nga asetet e dhuruara	9 72,716	-
Shpenzimet akruale	3,244	-
Totali detyrimet afatshkurtra	331,109	45,828
EKUITETI		
Kapitali	10 15,790,921	7,345,141
Fitimi i akumuluar	175,868	(3,149)
Total ekuiteti	15,966,789	7,341,992
TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET	16,297,898	7,387,820

Të aprovuara dhe lëshuara nga menaxhmenti dhe të nënshkruara në emër të tij më 12 Qershor 2018.


Besnik Berisha
Drejtor Menaxhues




Vjosa Balaj
Menaxhere e Lartë Financiar

Shënimet përcjellëse në faqet 7 deri në 21 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Kosovar Për Garanci Kreditore
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

	Shënimet	Për fund vitin 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Tarifat e garancisë	11	134,165	7,070
Të ardhurat tjera	12	269,364	-
Total të ardhurat		403,529	7,070
Shpenzimet e personelit	13	(87,043)	
Zhvlerësimi	7,8	(20,415)	
Shpenzimet operative	14	(38,759)	
Provizioni neto për humbje nga garancionet	15	(78,295)	(10,219)
Fitimi i vitit		179,017	(3,149)
Të Ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		179,017	(3,149)

Shënimet përcjellëse në faqet 7 deri në 21 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Kosovar Për Garanci Kreditore
Pasqyra e Ndryshimeve në Bilancin e Fondit
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

	Kapitali	Fitimi i	Totali
	(EUR)	akumuluar	(EUR)
		(EUR)	
Më 1 Janar 2016	-	-	-
Kapitali i paguar	7,345,141	-	7,345,141
Humbja e vitit	-	(3,149)	(3,149)
Më 31 Dhjetor 2016	<u>7,345,141</u>	<u>(3,149)</u>	<u>7,341,992</u>
Kapitali shtesë i paguar	8,445,780	-	8,445,780
Fitimi i vitit	-	179,017	179,017
Më 31 Dhjetor 2017	<u>15,790,921</u>	<u>175,868</u>	<u>15,966,789</u>

Shënimet përcjellëse në faqet 7 deri në 21 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Kosovar Për Garanci Kreditore
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë
Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

	Shënim et	Për fund vitin 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese:			
Fitimi/(Humbja) e vitit		179,017	(3,149)
Korrigjimet për:			
Zhvlerësimi	7,8	20,415	-
		199,432	(3,149)
Lëvizjet në kapitalin qarkullues:			
Rritja në të arkëtueshme		(143,456)	(8,209)
Rritja e të hyrave të shtyra tarifave të garancive		131,026	35,609
Rritja në humbjet e provizioneve nga garancionet e kredive		78,295	10,219
Rritja për të hyrat e shtyra nga asetet e dhuruara		72,715	-
Rritja në akruale		3,244	-
Neto paraja e gjeneruar në aktivitetet operuese		341,256	34,470
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese:			
Shtesat e aseteve		(98,953)	-
Depozitat		(8,500,000)	-
Neto paraja e përdorur nga aktivitetet investuese		(8,598,953)	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese:			
Kapitali i paguar		8,445,780	7,345,141
Neto paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		8,445,780	7,345,141
Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të saj gjatë vitit		188,083	7,379,611
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		7,379,611	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	4	7,567,694	7,379,611

Shënimet përcjellëse në faqet 7 deri në 21 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është një institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm që u lëshon garanci institucioneve financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e NMVM-ve. FKKG është themeluar në Janar 2016, si rezultat i iniciativës së përbashkët ndërmjet donatorëve ndërkombëtarë në Kosovë (kryesisht USAID dhe KfW) dhe Qeverisë së Kosovës, në bazë të Ligjit për Themelimin e Fondit për Garantimin e Kredive të Kosovës.

Përmes “Ligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore”, Ligji nr. 05/L - 057, FKKG-ja është themeluar si institucion i pavarur, jofitimprurës, publik, autonom, subjekt juridik, si dhe janë përcaktuar autorizimet e tij, struktura, qeverisja, operacionet, fushëveprimi, si dhe politikat e procedurat për dhënien e Garancive Kreditore.

Ligji themelues i FKKG-së është iniciuar nga MTI, ndërsa USAID-i në Kosovë, përmes Programit të Mbështetjes së Kredive të EMPOWER (ECS) e mbështeti institucionin për të zhvilluar aktivitetin operativ. Ligji hyri në fuqi më 23 Janar 2016. Kapitali i FKKG-së përbëhet nga fondet e dhuruara nga MTI, USAID dhe KfW.

FKKG-ja është krijuar për të ndihmuar në plotësimin e nevojave për qasje më të madhe në financim të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjes së prodhimit lokal dhe shërbimeve me vlerë të shtuar, si dhe përmirësimit të bilancit tregtar dhe rritjes së mundësive për financim të NMVM-të.

FKKG-ja është subjekt i pavarur, autonom, juridik i themeluar me Ligj, me subjektivitet të plotë juridik, si dhe identitet ligjor që është i ndarë dhe i ndryshëm nga Bordi Menaxhues dhe Ekzekutivi i FKKG-së.

FKKG-ja udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve, i cili përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët bashkërisht kanë shumë vite përvojë në menaxhimin financiar, menaxhimin e riskut, të drejtën tregtare e financiare, si dhe në auditim. Bordi siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje për të gjitha aktivitetet e FKKG-së.

FKKG-ja është themeluar me qëllim të sigurimit të pjesshëm të garancive të kredive për institucionet financiare, për kreditë që i jepen NMVM-ve, deri në shumën e mbulimit të përcaktuar me LFKGK dhe Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet FKKG-së dhe institucionit financiar.

Për qëllimet e veprimtarisë kryesore, FKKG-ja është përgjegjëse për:

- a. Lëshimin e Garancive Kreditore në përputhje me LFKGK-në dhe politikat e brendshme të miratuara nga Bordi i Drejtorëve;
- b. Vendosjen e kushteve për regjistrimin e institucioneve të kualifikuara financiare të Kosovës në FKKG, sipas Politikës për Regjistrimin e Institucioneve Financiare;
- c. Caktimin e kushteve për lëshimin e Garancive Kreditore nga FKKG-ja.
- d. Caktimin e Tarifave të Garancive të FKKG-së.
- e. Depozitimin apo investimin e drejtpërdrejtë, apo përmes delegimit të autorizimeve, të aseteve të FKKG-së brenda kufizimeve të LFKGK-së.
- f. Pagesën e Shumave të pagueshme për Garancitë Kreditore për institucionet financiare të regjistruara në pajtim me dispozitat e LFKGK dhe Marrëveshjes së Garancisë, në përputhje me dispozitat e LFKGK dhe Politikave për Trajtimin e Kërkesave.

1. TË PËRGJITHSHME (VAZHDIM)

Kapitali minimal i FKKG-së është 300,000.00 Euro, sipas nenit të 10 të LFKKG-së.
Organet qeverisëse të FKKG-së janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues. Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë drejtues i FKKG-së.
Numri fiskal i FKKG-së është 601642061.

Operacionet e FKKG-së dhe të gjitha aktivitetet administrative janë të pavarura që nga data 10 qershor 2017 dhe janë nën menaxhimin e Fondit të mbështetur nga asistenca teknike e USAID-it.

Më 6 dhjetor 2017 Fondi për Garantimin e Kredive të Kosovës (FKKG) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë me Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë.

Mbështetja e portofolit të garantuar të FKKG-së nga Sida, do të rrisë më tej aftësinë e Fondit për të siguruar një nivel më të lartë të garancive të kredisë, duke rritur në të njëjtën kohë qëndrueshmërinë financiare të sektorit. Qëndrueshmëria do të reflektojë në lehtësimin e ndërmjetësimit financiar, duke rritur kështu qasjen në financimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, me qëllim të promovimit të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës për gra, burra dhe të rinjtë e të gjitha etnive në Kosovë.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), siç janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Pasqyrat financiare janë përgatitur me anë të bazave të vlerësimit të specifikuara nga SNRF-ja për çdo lloj aset, detyrimi, të ardhurash apo shpenzimesh. Bazat e vlerësimit janë të përshkruara në hollësi në Shënimin si më poshtë.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-në kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkon nga menaxhmenti të shfrytëzojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Fondit.

2.2 Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet në fuqi nga 1 Janari 2017

Një numër i standardeve të reja që janë lëshuar nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit, interpretime dhe amendamente të lëshuara nga Komiteti i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) kanë hyrë në fuqi për periudhën që fillon nga (ose pas) 1 Janar 2017.

Shënim: jo të gjitha standardet dhe interpretimet e reja që kanë hyrë në fuqi për herë të parë për periudhën nga (ose pas) 1 Janar 2017 kanë efekt në pasqyrat financiare të Fondit.

SNK 8:28 - Efekti i zbatimit fillestar të SNRF-së në politikat kontabël të Fondit.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.2 Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet në fuqi nga 1 Janari 2017 (vazhdim)

Standardet e reja, interpretimet dhe ndryshimet që hyjnë në fuqi për herë të parë për periudhat që fillojnë nga (ose pas) 1 Janar 2017:

- Vlerësimi vjetor i ciklit të SNRF 2014-2016 (Ndryshimet në SNRF 12 Shpalosja e Interesit në njësitë e tjera
- SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat (Amendamentet - Njohja e Pasurive Tatimore të Shtyra në Humbjet e Perealizuara)
- SNK 7 Pasqyra e Rrjedhës së Parasë (Amendamentet në Iniciativat e Shpalosjeve).

Qëllimi i SNRF 12 është sqaruar për të bërë të qartë se kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese në këtë standard, përveç atyre në paragrafët B10 - B16, zbatohen për interesa pavarësisht nëse ato klasifikohen si të mbajtura për shitje, siç mbahet për t'u shpërndarë pronarëve ose si operacionet e ndërprera në përputhje me SNRF 5.

Ndryshimi në SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat qartëson kontabilizimin për pasuritë tatimit të shtyrë në lidhje me instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë, por që nuk konsiderohen të zhvlerësuara (për shembull, një investim në një normë fikse obligacioni ku vlera e drejtë ka rënë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit, por asetit nuk konsiderohet të jetë zhvlerësuar në vlerë). Në mënyrë të veçantë sqaron se tatimet e shtyra duhet të njihen sipas diferencave të përkohshme të zbritshëm që rrjedhin nga humbjet e perealizuara në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e njohjes për tatimet e shtyra, dhe pavarësisht nëse është planifikuar të rikuperojë instrumentin nëpërmjet shitjes ose mbajtjes së tij deri në maturim.

Amendamenti i SNK 7 synon të përmirësojë informacionin në lidhje me ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e financimit. Një mënyrë për të siguruar këtë shpalosje do të ishte të sigurojë një koordinim të vlerave kontabël të hapjes dhe mbylljes për çdo zë për të cilin flukset e mjeteve monetare kanë qenë ose do të klasifikoheshin si aktivitete financiare. Koordinimi do të përfshinte:

- Ndryshimet nga financimi i rrjedhës së parasë;
- Ndryshimet që rrjedhin nga marrja ose humbja e kontrollit të filialeve ose bizneseve të tjera;
- Shkëmbimet tjera jo-monetare (p.sh. ndryshimet në kurset e këmbimit valutor, qiraja e re financiare dhe ndryshimet në vlerën e drejtë);

Nuk ka pasur standarde dhe interpretime të reja efektive për herë të parë për periudhat që fillojnë nga (ose pas) 1 Janarit 2017 dhe që kanë një efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare.

2.3 Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet që janë efektive në periudhën pas vitit që mbaron më 31 Dhjetor 2017

Ekzistojnë një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që kompania ka vendosur të mos i miratojë në fillim. Më të rëndësishmet nga këto janë:

- SNRF 9 Instrumentet Financiare (efektive për periudhat duke filluar nga (ose pas) 1 Janarit 2018); dhe
- SNRF 16 Qiratë (efektive për periudhat duke filluar nga (ose pas) 1 Janarit 2019)

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.3 Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet që janë efektive në periudhën pas vitit që mbaron më 31 Dhjetor 2017 (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet Financiare

Fondi ka identifikuar se miratimi i SNRF 9, i cili zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare:

Fondi do të duhet të aplikojë nga 1 Janari 2018 një model të pritshëm të humbjes së kredisë gjatë llogaritjes së humbjeve nga zhvlerësimi në të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshmet e tjera (aktuale dhe jo-aktuale). Kjo do të rezultojë në rritje të provizioneve të dëmtuara dhe në një gjykim më të madh për shkak të nevojës për të analizuar informacionin e kërkuar kur vlerësohet shuma e duhur e provizioneve. Gjatë zbatimit të SNRF 9, kompania duhet të marrë në konsideratë probabilitetin e një mospagimi që ndodh gjatë jetës kontraktuale të llogarive të arkëtueshme dhe kontratat e bilancit të aseteve sipas njohjes fillestare të këtyre aseteve.

SNRF 16 Qiratë

Aprovimi i SNRF 16 do të rezultojë në Fond në njohjen e drejtë të aseteve dhe detyrimeve të qirasë për të gjitha kontratat që janë, ose përfshijnë, një kontratë qiraje. Për qiratë aktualisht të klasifikuara si qira operationale, sipas kërkesave të tanishme të kontabilitetit kompania nuk i njeh asetet ose detyrimet përkatëse, dhe në vend të kësaj i ndan pagesat e qirasë në mënyrë të drejtë mënyrë sipas afatit të qirasë, duke shpalosur në pasqyrat financiare vjetore detyrimin total financiar.

Të tjera

Fondi nuk pret ndonjë standard tjetër të nxjerrë nga BSNK, dhe jo efektiv, që të ketë ndonjë ndikim material në Fond.

Më poshtë gjeni një listë e standardeve të reja dhe të ndryshuara të cilat, në kohën e shkrimit, ishin lëshuar nga BSNK, por që janë efektive në periudhat e ardhshme. Vlera e detajeve të matura dhe cilësore që do të jepen për secilën prej standardeve, ashtu si shuma e detajeve që duhet dhënë për SNRF 9, 15 dhe 16, varen nga rrethanat e secilës Fond.

- KIRFN Interpretimi 22 Transaksionet në Valutë të Huaj dhe Trajtimi Paraprak (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2018)
- Ndryshime në SNRF 2 Klasifikimi dhe Matja e Transaksioneve për Pagesat e Bazuara në Aksione (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2018)
- Ndryshime në SNRF 4: Aplikimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2018)
- Ndryshime në SNK 40: Transferimet e Investimeve të Pronës (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2018)
- Vlerësimi vjetor i cikleve të Standardeve të SNRF-ve 2014-2016 që kanë të bëjnë me çështjet në SNRF 1. Adaptimet e para në SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Kompanitë e Përbashkëta (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2018)
- KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2019);
- Tiparet e parapagimit me kompensim negativ (Ndryshime në SNRF 9), (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2019)
- Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Kompanitë e Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28) (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2019)
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve (data e hyrjes në fuqi më 1 Janar 2021)

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.4 Asetet financiare

Fondi i klasifikon asetet e veta financiare në këto kategori: asete financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe të arkëtueshmet, të mbajtura deri në maturim dhe në asete financiare të disponueshme për shitje. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e investimeve të veta në vlerësimin fillestar.

Asetet financiare në vlerë të drejtë

Asetet financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes mbahen për tregtim. Aseti financiar klasifikohet në këtë kategori nëse është siguruar kryesisht për qëllimin e shitjes në afat të shkurtër. Asetet në këtë kategori klasifikohen si asete qarkulluese. Fondi nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori.

Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Ato përfshihen në asetet qarkulluese. Në datën e raportimit, kjo kategori përfshinë paratë dhe ekuivalentët e paratë.

2.5 Paraja dhe ekuivalentët e paratë

Paraja dhe ekuivalentët e paratë përfshijnë paratë në dorë dhe balancat në bankë. Fondi ka llogari bankare të hapur në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe një llogari rrjedhëse me Bankën për Biznes.

2.6 Bilanci i Fondit

Bilanci i Fondit i dhënë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe USAID-i si grant. Gjatë Dhjetorit të vitit 2017, janë nënshkruar marrëveshjet për grant në shumën prej 7.450 milionë Euro ndërmjet Bankës Gjermane të Zhvillimit (KfW) dhe Ministrisë së Financave, me qëllim të rritjes së kapitalit të FKGK-së për 7.0 milionë Euro, ndërsa 450 mijë Euro janë dhënë për asistencë teknike.

2.7 Tatimi në të ardhura aktuale dhe të shtyra

Sipas LFKGK, Fondi është i përjashtuar nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, TVSH-ja dhe tatimi mbi dividendët, interesat ose të ardhurat nga investimet e fituara nga fondet për garancitë ose investimet e kreditit, si dhe çdo detyrim tjetër, mbajtje në burim ose taksë për çdo aspekt të veprimtarisë së Fondit.

2.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet njihen kur plotësohen këto kushte:

- Shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike që lidhen me transaksionin do të rrjedhin tek njësia ekonomike;
- Faza e përfundimit të transaksionit në datën e pasqyrës së pozicionit financiar mund të matet në mënyrë të besueshme; dhe
- Kostot e kryera për transaksionin dhe koston e kryerjes së transaksionit mund të maten në mënyrë të besueshme

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.8 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Të ardhurat e Fondit janë:

- (i) Të ardhurat nga tarifat e garancive
- (ii) Interesi nga investimi

Tarifat e Garancisë

Pasi që kredia të pranohet dhe të vihet nën garanci, kalkulohet gjithashtu edhe tarifa e garancisë. Tarifa e garancisë kalkulohet në bazë të përqindjes aktuale të garancisë të përcaktuar për një Marrëveshje Garancie shumëzuar me shumën e aprovuar të garancisë. Të ardhurat nga taksa e garancisë njihen në bazë të përlogaritjes për një periudhë prej 12 muajsh.

Tarifat e garancisë njihen si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në fund të çdo muaji duke debituar akrualin e Tarifës së Garancisë dhe kredituar Tarifën e Garancisë.

Interesi nga investimet

Investimi nënkupton investimet e fondeve të tepërta ku parimi kryesor që udhëheq investimin e këtyre fondeve është të sigurojë që objektivat parësore të ruajtjes së aseteve të FKGGK-së dhe kufiri i rrezikut të tij janë të balancuara me arritjen e një kthimi të kënaqshëm.

2.9 Provizioni

Politika e provizionit specifikon procesin e lënies anash të rezervave të caktuara për të gjitha kreditë që vihen nën garancinë, e që priten të kenë apo mund të kenë pasur humbje kreditore. Politika e provizionit është bërë në përputhje me SNRF 9. Provizionimi i Garancisë Kreditore bëhet në tri faza, bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare. Informatat e siguruar nga IFR në lidhje me klasifikimin e kredisë do të jenë nxitësi kryesor për lëvizjen e garancisë kreditore në fazë dhe për matjen e riskut kreditor. Provizionimi në fazën e parë bëhet për të gjithë Garancionin Kreditore pa marrë parasysh cilësinë e kredisë, në bazë të humbjes së pritur brenda një periudhe prej 12 muajsh. Garancia kreditore kalon në fazën e dytë (ose nga e dyta në të tretën) nëse ka përkeqësim të konsiderueshëm në cilësinë e kredisë, nëse rrjedha e parasë kontraktuale tek aset financiar nuk është plotësisht e rikuperueshme në rast të dështimit të pagesës. Në të dyja këto faza, provizioni njihet bazuar në humbjet e pritshme përgjatë gjithë ciklit. Transferimi i aseteve financiare nga njëra fazë në tjetrën është simetrike, që do të thotë se çdo aset financiar mund të zhvendoset, nëse ka përmirësim të konsiderueshëm në cilësinë e kredisë.

2.10 Kontingjentet dhe zotimet

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato zbulohen vetëm nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv kontingjent nuk njihet në pasqyrat financiare por zbulohet kur një fluks i përfitimeve ekonomike është i mundshëm. Shuma e humbjes kontingjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhme të konfirmojnë një detyrim të tillë të shkaktuar në datën e pasqyrës së gjendjes financiare si dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që shkaktohet.

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

3.1 Hyrje dhe të përgjithshme

Risku përkufizohet si efekt i ngjarjeve të pasigurisë dhe rezultateve të tyre që mund të kenë efekt të rëndësishëm tek operacionet e FKGK-së. Menaxhimi i riskut është procesi i vlerësimit dhe reagimit ndaj rreziqeve me qëllim të reduktimit të atyre rreziqeve deri në nivele të pranueshme. Vlerësimi i riskut bazohet në identifikimin e kërcënimeve, si dhe gjasat që ato kërcënime të realizohen dhe ndikimin e tyre potencial mbi FKGK-në. Menaxhimi i riskut përdor rezultatet e vlerësimeve të rrezikshmërisë për të marrë vendime dhe për të koordinuar aktivitetet për të drejtuar dhe kontrolluar një organizatë në lidhje me riskun.

Politika e Menaxhimit të Riskut e FKGK-së përcakton parimet kryesore për të krijuar një sistem të përshtatshëm të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të riskut. Parimet themelore për menaxhimin e riskut janë të reflektuara në Marrëveshjen e Garancisë, në politikat dhe procedurat ekzistuese, si dhe tek metodologjitë dhe instrumentet për matjen, monitorimin dhe raportimin e riskut. Së bashku, këto formojnë strukturën e menaxhimit të riskut në FKGK-së.

3.2 Struktura e menaxhimit të riskut

Struktura e menaxhimit të riskut të FKGK-së thekson mbikëqyrjen dhe kontrollin e riskut, si dhe përcakton proceset dhe mekanizmat me të cilët merren dhe zbatohen vendimet për rreziqe. Struktura e menaxhimit të rrezikut të FKGK-së fillon me mbikëqyrjen nga Bordi i Drejtorëve. Bordi merr informata të rregullta mbi rreziqet kryesore të FKGK-së bashkë me një përmbledhje gjithëpërfshirëse të profilit të riskut dhe efektshmërisë së portofolit kundrejt qëllimeve të përcaktuara, që i prezantohet në baza tremujore Bordit. Bordi përcakton nivelet maksimale të riskut për rrezikun kreditor dhe rrezikun e likuiditetit, si dhe miraton politikat, kufizimet dhe strategjitë. Bordi gjithashtu siguron që FKGK-ja po merr masat e duhura për të arritur një baraspeshë të kujdesshme ndërmjet riskut dhe përfitimit.

Bordi i Drejtorëve ka themeluar dy komisione për të mbikëqyrur fushat specifike si dhe për të përgatitur temat për shqyrtim nga Bordi: Komiteti i Menaxhimit të Riskut dhe Komiteti i Auditimit.

Komiteti për Menaxhimin e Riskut - komiteti shqyrton dhe dorëzon rekomandime tek Bordi i Drejtorëve në lidhje me nivelin maksimal të riskut të FKGK-së, politikat e riskut, udhëzimet për riskun, kapitalin, leverazhin, likuiditetin, produktet dhe shërbimet nga këndvështrimi i riskut, si dhe cilësinë kreditore të portofolit të kredive.

Komiteti i Auditimit - komiteti vepron si komitet përgatitor për Bordin e Drejtorëve në lidhje me çështjen e kontabilitetit dhe auditimit, duke përfshirë edhe çështjet e lidhura me riskun.

Në përgjithësi, të dy komitetet e ndihmojnë Bordin e Drejtorëve që të sigurojë menaxhim strikt të riskut brenda FKGK-së, si dhe për të siguruar që menaxhimi dhe raportimi mbi riskun të jenë gjithmonë në përputhje me ligjin dhe parimet e përgjithshme të FKGK-së.

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.3 Risku kreditor

Risku kreditor është rreziku i humbjeve që rezultojnë nga dështimi i kredi marrësit që të përmbushë obligimet financiare apo kontraktuale ndaj bankës. Rreziqet e FKGG-së qëndrojnë tek bankat. Nëse kreditë e provizionuar në një bankë të caktuar rriten, duke e vënë portofolin e tyre në rrezik, kjo e rrit edhe rrezikun e FKGG-së, në kuptimin që FKGG-së mund t'i duhet të mbulojë garancitë e lëshuara. Kjo do të ketë ndikim tek pozicioni i kapitalit të FKGG-së si dhe të ardhurat e pritura nga tarifat. Prandaj, vlerësimi i kredive i palëve të FKGG (IFR) dhe politikat e tyre do të ndikojnë në cilësinë e portofolit të garantuar të FKGG-së.

Me qëllim të regjistrimit të institucioneve financiare, FKGG-ja ka implementuar një Politikë Regjistrimi që ka për qëllim të sigurojë regjistrimin vetëm të institucioneve financiare që janë të përgjegjshme dhe transparente, si dhe ofrojnë dëshmi të aftësisë së tyre për të përmbushur kërkesat e FKGG-së. Politika e regjistrimit përcakton parimet kryesore që institucionet financiare duhet t'i kenë për t'u regjistruar në FKGG:

- Bazë të fortë të kapitalit dhe të pozicionit financiar
- Reputacion të mirë në treg
- Vullnet për t'u zgjeruar në segmentin e NMVM-ve
- Vullneti për të zvogëluar kërkesat e kolateralit si reagim i baraspeshuar ndaj garancive të pjesshme të kredive nga FKGG-ja
- Politikat dhe procedura të shëndosha të dhënies së kredive

Për të siguruar zotimet e garancive që merr përsipër FKGG-ja brenda kapacitetit të vet të bartjes së rrezikut, si dhe që portofoli i tij të jetë i diversifikuar mirë, FKGG-ja ka miratuar një Politikë Alokimi. Kjo politikë përcakton fazën maksimale të riskut që FKGG-ja është e gatshëm të marrë përsipër, si dhe vendos metodologjinë e vlerësimit të ekspozimit të IFR-ve. Politika gjithashtu përcakton metodologjinë për vlerësimin e IFR-ve dhe kufijve të alokimit për IFR-të. Metodologjia përcakton që kriteret kryesore për alokimin e një kufiri fillestar janë pjesa e tregut dhe profili i riskut. Megjithatë, kufijtë e ekspozimit mund të korrigjohen nga FKGG-ja. Arsyet për korrigjim do të përfshijnë dështimin për të përdorur kufirin e alokuar në mënyrë të konsiderueshme ose fare, cilësinë e dobët të kredive të dorëzuara për garanci, ose çështje të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë në gjendjen e përgjithshme të bankës.

4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.4 Risku i likuiditetit

Menaxhimi efektiv i riskut të likuiditetit është thelbësor për të ruajtur besimin e donatorëve dhe IFR-ve, si dhe për të mundësuar që veprimtaria bazë të vazhdojë të gjenerojë të ardhura, edhe në rrethana të pafavorshme. Marrëveshjet e besueshme, analiza e kriterëve të likuiditetit, si dhe planifikimi kontingjent (për shembull një stand-by linjë e kredisë ose një marrëveshje kundër garancisë) janë elemente thelbësore të likuiditetit të fortë.

FKGK thekson që kapitali që ajo mban si asete likuide duhet të sigurojë mbështetjen drejt përmbushjes së objektivave të veta. Prandaj është e angazhuar me parimet e arritjes së vlerës për para në menaxhimin e thesarit dhe për përdorimin e teknikave të përshtatshme të matjes së performancës që balancojnë rrezikun dhe shpërblimin, brenda kontekstit të administrimit efektiv të riskut.

Për qëllimet e optimizimit të kthimeve potenciale brenda parametrave të pranueshëm të riskut, FKGK-ja ka përgatitur një politikë investimi që përcakton qartë strukturën e investimeve në përputhje me mandatin e FKGK-së dhe objektivave të tij strategjikë.

31 Dhjetor 2017				
Aktuale				
	Deri në 1 vit	1 deri në 2 vite	2 deri në 5 vite	Mbi 5 vite
	(EUR)	(EUR)	(EUR)	(EUR)
Asetet financiare				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7,567,694	-	-	-
Depozitat	-	8,500,000	-	-
Gjithsej asete financiare	7,567,694	8,500,000	-	-
Detyrimet financiare				
Të pagueshmet dhe detyrimet tjera	258,393	-	-	-
Gjithsej detyrime financiare	258,393	-	-	-

31 Dhjetor 2016				
Aktuale				
	Deri në 1 vit	1 deri në 2 vite	2 deri në 5 vite	Mbi 5 vite
	(EUR)	(EUR)	(EUR)	(EUR)
Asetet financiare				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7,379,611	-	-	-
Gjithsej asete financiare	7,379,611	-	-	-
Detyrimet financiare				
Të pagueshmet dhe detyrimet tjera	45,828	-	-	-
Gjithsej detyrime financiare	45,828	-	-	-

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.5 Risku operativ

Rreziku operativ përcaktohet si rreziku i humbjes që del nga proceset e papërshtatshme ose të dështuara të brendshme, nga njerëzit dhe sistemet ose nga ngjarje të jashtme.

Risku operativ mund të vijë nga një spektër i gjerë i ngjarjeve të ndryshme të jashtme, duke filluar nga dështimet e energjisë e deri tek vërshimet apo tërmetet.

Ngjashëm, risku operativ mund të lindë për shkak të ngjarjeve të brendshme, të tilla si potenciali për dështim apo mospërputhje në ndonjërin prej proceseve dhe sistemeve të FKGK-së, apo ndonjërit prej ofruesve të jashtëm të shërbimeve. Risku operativ që rrjedh nga menaxhimi i resurseve njerëzore mund të nënkuptojë një sërë çështjesh, si punëtorët nën menaxhim të dobët apo me trajnim të dobët; potenciali për neglizhencë apo kundërvajtje të qëllimshme; konflikti i interesave; mashtrimi; veprimi armiqësor e kështu me radhë. Menaxhimi i riskut operativ në FKGK fokusohet tek masat proaktive, ashtu që të siguroar vazhdimësinë e punës, por edhe tek saktësia e informatave që përdoren së brendshmi dhe raportohen së jashtmi, një stafi kompetent dhe mirë-informuar, dhe respektimin e rregullave dhe procedurave të përcaktuara, si dhe të masave të sigurisë për të mbrojtur infrastrukturën fizike dhe të teknologjisë në FKGK- së.

Sistemi i menaxhimit të riskut operativ në FKGK:

I) Strategji të qarta të miratuara nga Bordi i Drejtorëve, si dhe mbikëqyrje të kontrolluar nga Menaxhmenti i Lartë;

II) Kulturë e fuqishme e brendshme për riskun operativ (kultura e brendshme e riskut operativ nënkupton tërësinë e kombinuar të vlerave, qëndrimeve, kompetencave e sjelljeve individuale e kolektive që krijojnë përkushtimin e institucionit dhe llojin e menaxhimit të riskut operativ), si dhe kultura e kontrollit të brendshëm, që thekson kontrollin e dyfishtë;

III) Standarde të larta të etikës dhe integritetit, si dhe

IV) Zotimi ndaj qeverisjes efektive korporative, që përfshin, mes tjerash, ndarjen e detyrave, shmangien e konflikteve të interesit, si dhe linjat e qarta të përgjegjësisë së menaxhmentit, llogaridhënies dhe raportimit, siç edhe pasqyrohen në dokumentet e qeverisjes së FKGK-së. Të gjitha nivelet e stafit duhet të kuptojnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me menaxhimin e riskut operativ.

Politikat e sigurimit mund të përdoren për të përballuar humbjet që mund të ndodhin si pasojë e ngjarjeve siç janë pretendimet e palëve të treta që rezultojnë nga gabimet dhe mosveprimet, mashtrimet e punonjëseve ose palëve të treta dhe fatkeqësitë natyrore.

3.6 Instrumentet financiare të prezantuara në vlerën e drejtë

Asetet financiare të matura sipas vlerës së tyre të drejte në deklaratën e gjendjes financiare në pajtim me hierarkinë e vlerës së drejte janë prezantuar në tabelën e mëposhtme. Kjo hierarki i grupon asetet dhe pasivet financiare në tri nivele që janë të bazuara në rëndësinë e të dhënave hyrëse që janë përdorur gjatë vlerësimit të vlerës së drejte të aseteve financiare. Hierarkia e vlerës reale është si vijon:

- **Niveli 1:** çmimi i kuotuar (jo i rregulluar) në tregjet aktive për asetet dhe pasivet e njëjta;
- **Niveli 2:** të dhënat e tjera hyrëse, përveç çmimeve të kuotuar, të përfshira në nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për vështirimet e drejtpërdrejta të aseteve apo pasiveve (p.sh çmimet), apo në mënyrë indirekte (p.sh i bërë nga çmimi); dhe
- **Niveli 3:** të dhënat hyrëse mbi asetet dhe pasivet që nuk janë të bazuara në të dhënat të cilat janë në dispozicion për vëzhgimin e tregut

Më 31 Dhjetor 2017, Fondi nuk ka asete financiare të matura me vlerë reale të drejtë.

3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

3.7 Instrumentet financiare që nuk janë prezantuar në vlerë të drejtë

Tabela në vijim përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta për ato aktive dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë:

	Vlera e bartur 2017 (EUR)	Vlera reale 2017 (EUR)
Asetet financiare		
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	7,567,694	7,567,694
Depozitat	8,500,000	8,500,000
Gjithsej asetet financiare	16,067,694	16,067,694
Detyrimet Financiare		
Të pagueshmet dhe detyrimet tjera	258,393	258,393
Gjithsej detyrimet financiare	258,393	258,393

4. PARAJA DHE EKVIVALENTET E PARASË

	Më 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Paraja në Bankën Qendrore të Kosovës	7,542,060	7,379,611
Llogaritë rrjedhëse	25,224	-
Paraja në arkë	410	-
Gjithsej paraja dhe ekuivalentet e parasë	7,567,694	7,379,611

5. DEPOZITAT

Total depozitat e investuara gjatë vitit 2017 janë në vlerë prej 8,500,000 Euro. Investimet, të cilat duhet të kenë një maturim maksimal prej 5 viteve, janë të kufizuara për organizatat që plotësojnë kriteret e miratuara nga Bordi i Drejtorëve të FKGK-së.

6. LLOGARITË E ARKËTUESHME DHE KËRKESAT TJERA

	Më 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Të arkëtueshmet nga klientët	65,495	8,209
Interesi akruar i depozitave bankare	69,493	-
Avance	16,677	-
Gjithsej të arkëtueshmet	151,665	8,209

7. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Pajisjet	IT Pajisjet	Mobilet e zyrës	Total
	(EUR)	(EUR)	(EUR)	(EUR)
Kosto historike				
Më 1 Janar 2016	-	-	-	-
Shtesat gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2016	-	-	-	-
Transferet	1,972	50,431	19,947	72,350
Shtesat gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2017	1,972	50,431	19,947	72,350
Zhvlerësimi i akumuluar				
Më 1 Janar 2016	-	-	-	-
Zhvlerësimi për vitin	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2016	-	-	-	-
Transferet	1,100	16,901	15,890	33,891
Zhvlerësimi për vitin	369	9,441	2,710	12,520
Më 31 Dhjetor 2017	1,469	26,342	18,600	46,411
VLERA NETO E ASETEVE				
Më 31 Dhjetor 2017	503	24,089	1,347	25,939
Më 31 Dhjetor 2016	-	-	-	-

Pas datës 10 Qershor 2017 FKGK-së i janë transferuar të gjitha kompetencat mbi institucionin (FGK-në), duke transferuar gjithashtu edhe asetet që deri atëherë kanë qenë nën menaxhimin e USAID-it.

8. PASURITË E PAPREKSHME

	Software-i (EUR)	Total (EUR)
Kosto historike:		
Më 1 Janar 2016	-	-
Shtesat gjatë vitit	-	-
Më 31 Dhjetor 2016	-	-
Transferet	66,825	66,825
Shtesat gjatë vitit	5,922	5,922
Më 31 Dhjetor 2017	72,747	72,747
Zhvlerësimi i Akumuluar		
Më 1 Janar 2016	-	-
Amortizimi për vitin	-	-
Më 31 Dhjetor 2016	-	-
Transferet	12,252	12,252
Zhvlerësimi i vitit	7,895	7,895
Më 31 Dhjetor 2017	20,147	20,147
Vlera neto e Aseteve		
Më 31 Dhjetor 2017	52,600	52,600
Më 31 Dhjetor 2016	-	-

9. TË HYRAT E SHTYRA NGA ASETET E DHURUARA

	Më 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Më 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Pajisjet	503	
IT Pajisjet	24,090	-
Mobilet e zyrës	1,346	-
Software-i	46,777	-
Total të hyrat e shtyra nga asetet e dhuruara	72,716	-

10. KAPITALI

Fondet e dhëna FKGGK-së janë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe USAID-i në formë granti.

Më datën 31 Dhjetor 2016 Fondet përfshijnë:

- Fondet e pranuar nga USAID-i në shumën prej 5,345,141 EURO.
- Fondet e pranuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (përmes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë) në shumën prej 2,000,000 Euro

Fondet shtesë nga grantet gjatë 2017:

- Fondet e pranuar nga KfW në shumën prej 7,000,000 Euro.
- Fondet e pranuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në shumën prej 1,000,000 Euro.
- Fondet e pranuar nga USAID-i në shumën prej 445,780 Euro.

11. TË ARDHURAT NGA TARIFAT E GARANCIVE

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Tarifat e garancive	134,165	7,070
Gjithsej të ardhurat nga tarifa e garancisë	134,165	7,070

Pasi që kredia të pranohet dhe të garantohet, kalkulohet edhe tarifa e garancisë. Tarifa e garancisë kalkulohet në bazë të përqindjes së tarifës aktuale të garancisë specifikuar për një Marrëveshje Garancie (2%), shumëzuar me Shumën e Aprovuar të garancisë. Të ardhurat nga tarifatat e garancisë njihen në baza akruale për një periudhë 12 mujore. Tarifatat e garancive njihen si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në fund të muajit, duke debituar Tarifën Akruale të Garancisë, si dhe duke kredituar të ardhurat nga Tarifatat e Garancive.

12. TË ARDHURAT TJERA

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Fondet për shpenzimet operative	179,555	-
Zhvlerësimi i aseteve të dhuruara	20,316	-
Interesi nga depozitat	69,493	-
Total të ardhurat tjera	269,364	-

Fondet për shpenzimet operative janë qëllimi i veprimtarisë së USAID-it për të mbështetur FKGK-në në mënyrë që të rritet biznesi i saj i sigurimit të garancive të pjesshme të kredisë për të lehtësuar zgjerimin e kreditimit të bankave vendore në sektorin e mikro ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (MSME) të Kosovës. Veprimtaria do të mbulojë shpenzimet operative të FKGK-së (të tilla si pagat, qiraja e zyrave etj.) për një kohë të kufizuar pas skadimit të projektit ECS të USAID-it më 10 Qershor 2017. Bazuar në strukturën aktuale dhe të parashikuar të FKGK-së dhe shkallën e kthimit, parashikimet financiare duke përfshirë normat e rritjes së shfrytëzimit dhe të ardhurave, shuma e propozuar e financimit duhet të jetë e mjaftueshme për t'i mundësuar FKGK-së që të arrijë pavarësinë financiare (flukset monetare pozitive nga operacionet) jo më vonë se në fund të vitit 2018. Është e rëndësishme të theksohet se fondet nën këtë përfitim do të përdoren vetëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe jo për humbjet nga kreditë. FKGK-ja ka një rezervë të veçantë fondesh (llogaria kapitale e FKGK-së) e dedikuar për mbulimin e humbjeve të kredisë, të cilat në asnjë rast nuk pritet të materializohen deri në fund të vitit 2018, periudha e mbuluar nga ky përfitim.

13. SHPENZIMET E PERSONELIT

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Pagat	71,591	-
Kontributet pensionale	15,452	-
Total shpenzimet e personelit	87,043	-

14. SHPENZIMET OPERATIVE

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Shpenzimet e qirasë & komunale	11,267	-
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	7,380	-
Përkthimet dhe shërbimet tjera profesionale	6,090	-
Publikimet, Përfaqësimet dhe Marketingu	4,315	-
Shpenzimet e telefonit dhe internetit	2,133	-
Trajnimet, Konferencat dhe Seminaret	1,385	-
Provizionet bankare	807	-
Shpenzimet tjera	5,382	-
Total shpenzimet operative	38,759	-

15. SHPENZIMET E PROVIZIONIMIT NETO

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2017 (EUR)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (EUR)
Shpenzimet e provizionit	128,223	10,219
Të ardhurat nga provizioni	(49,928)	-
Total shpenzimet e provizioneve neto	78,295	10,219

Politika e provizionit specifikon procesin e ndarjes të disa rezervave për të gjitha kreditë që janë të garantuara, e që priten të shkaktojnë apo kanë pësuar humbje nga kredia. Politika e provizionit bëhet në pajtim me SNRF 9

16. ZOTIMET DHE KONTINGJENTET

	Më 31 Dhjetor 2017
Numri i garancive	Shuma e garantuar në pjesën e mbetur (EUR)
Total	739
	11,657,827

Përveç të tjerave ato që janë shpalosur më sipër, nuk ekzistojnë kontingjenca apo zotime në datën e bilancit.

17. TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA

Palët e ndërlidhura janë udhëheqesitë e Fondit. Palët konsiderohen të ndërlidhura nëse një palë e tillë ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër, apo të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo operative.

18. NGJARJET PASUESE

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasuese pas datës së raportimit, të cilat do të kërkonin korrigjime apo zbulime të informacioneve për këto pasqyra financiare.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Adresa:
Anton Çetta Nr. 5/A,
10,000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 38 225 600 ext. 208
Fax: +381 (0) 38 225 400

E-mail: info@fondikgk.org
www.fondikgk.org